

## KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot, më 26/05/2015 hartohet dhe nënshkruhet kjo kontratë nga dhe ndërmjet palëve të mëposhtme:

**SHITËSI:** **Orlean Zotaj**, i biri i Pajtimimit, lindur në Berat më 12/04/1980, dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga\_Ali Demi, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.029130414 dhe nr personal I00412055R

**BLERËSI:** **Gerta Dhana**, e bija e Kujtimit, lindur në Tirane, më 02.02.1988, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.026057103 dhe nr personal I85202047L

### Kushte të përgjithshme

- A. Shoqëria "**Pronto Gaz**" shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NUIS\_L41504010N\_\_. Kjo shoqëri ka për objekt të veprimtarisë
- Tregëtim me pakice, shumice si dhe shpërndarja e gazit të lengshëm dhe bomblave të gazit.
  - Transport i gazit të lengshëm dhe bomblave të gazit për vetë dhe për të tjerë.
- B. Shoqëria zotëron të gjitha licencat, autorizimet dhe lejet përkatëse të lëshuara nga autoritetet kompetente shqiptare për të zhvilluar objektin e saj të veprimtarisë.
- C. Shitësi është ortak i vetëm shoqërisë "**Pronto Gaz**" shpk, duke zotëruar 100 % të kapitalit
- D. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit **50 kuota dmth 50% të kapitalit** që zotëron në shoqërinë "**Pronto Gaz**" shpk.

- E. Blerësi është i interesuar të blejë **50 kuota dmth 50% te kapitalit** që Shitësi zotëron në kapitalin e shoqërisë "**Pronto Gaz "shpk.**
- F. Në përputhje me nenin 73 "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave" shkronja b, pika 1, te ligjit nr.9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" (i ndryshuar), nenin 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, hartohet kjo kontrate e shitjes së kuotave me kushtet si më poshtë vijon:

## Neni 1

### Objekti

#### Shitja dhe Blerja e Kuotave

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate, Shitësi i kalon Blerësit titullin e pronësisë, të parënduar me barrë, të **50 kuota dmth 50% te kapitalit** që zotëron në kapitalin e shoqërisë "**Pronto Gaz "shpk.** Të gjitha të drejtat e lidhura me kuotat në fjalë ndjekin kuotat dhe kalojnë gjithashtu në pronësi të Blerësit.

#### Kalimi i Pronësisë së Ligjshme mbi Kuotat

- 1.2 Blerësi do të bëhet zotërues me të drejta të plota i kuotave të blera në kapitalin e shoqërisë "**Pronto Gaz "shpk,** menjëherë, me nënshkrimin e kësaj kontrate nga të dyja palët.

## Neni 2

### Çmimi dhe Pagesa

- 2.1 Çmimi i plote i shitjes që Blerësi do t'i paguajë Shitësit për shitjen e Kuotave është i barabartë me **50 lek .**
- 2.2 Çmimi i shitjes do të paguhet nga Blerësi me lekë në dorë.
- 2.3 Në Datën e Nënshkrimit të kësaj kontrate, Blerësi do të jete pronari me të drejta të plota i **50 kuota dmth 50% te kapitalit** te blere. Kalimi i Kuotave nga Shitësi tek Blerësi dhe çdo dokument shoqërues do të regjistrohen nga administratori i Shoqërisë ose nga i autorizuari i tij në Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.

**Neni 3****Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit**

Shitësi deklaron dhe garanton se:

**3.1 Statusi i Shoqërisë**

Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më\_04/03/2014\_, me numër unik identifikimi NUIS L41504010N. Shoqëria është e organizuar në mënyrë të rregullt, ekziston në mënyrë të vlefshme dhe nuk është subjekt i procedurave të falimentimit apo likuidimit sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**3.2 Kuotat e parëduara me Barrë**

Kuotat përfaqësojnë 50 % të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, janë të lira nga çdo Barrë dhe nuk ka asnjë marrëveshje, për të krijuar apo rënduar me Barrë asnjë nga Kuotat.

**3.3 Pronari i ligjshëm**

Shitësi deklaron dhe garanton se ai është pronari i ligjshëm i kuotave që shiten dhe gëzon të drejtën të lidhë këtë Kontratë dhe t'i kalojë Blerësit Kuotat objekt të kësaj Kontrate.

**3.4 Përputhshmëria me ligjin**

Shoqëria kryen dhe ka kryer aktivitet tregtar, nga data e themelimit, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

**Neni 4****TË NDRYSHME**

- 4.1 Amendamentet: Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm me një marrëveshje me shkrim të të dyja palëve.
- 4.2 Pavlefshmëria: Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj kontrate. Kushti i pavlefshëm në këtë rast, do të zevendësohet me një të vlefshëm, i cili do t'i përkojë sa më shumë të jetë e mundur qëllimeve të palëve.

- 4.3 Ligji i zbatuar: Kjo Kontratë bazohet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.
- 4.4 Mosmarrëveshjet: Çdo mosmarrëveshje që mund dhe/ose rrjedh nga interpretimi, zbatimi, kryerja, shkelja ose përfundimi i kësaj Kontrate, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente.
- 4.5 Gjuha e kontratës: Kjo kontratë është hartuar në 3 kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga nje kopje për secilën palë dhe një kopje për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Palët pasi lexuan këtë Kontratë dhe janë dakort me përmbajtjen e saj, me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë nënshkruajnë si më poshtë.

**PALËT**

**SHITËSI**

**Orlean Zotaj**



**BLERËSI**

**Gerta Dhana**

*Gerta Dhana*  
*Gj*